



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**STRATEGJIA DHE POLITIKAT E MARKETINGUT
TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA**

Miratuar me Vendimin e Dekanatit

Nr. 150 datë 21.12.2021

Dhjetor 2021



Hyrje.....	2
1. Ngritja e Zyrës së Këshillimit të Karrierës së Studentëve	3
2. Projeksiuni i Imazhit të Institucionit	3
2.1. Modeli i ri i website zyrtar të FGJH-së.....	4
2.2. Përditësimi i faqes Facebook zyrtar të FGJH-së.....	5
2.3. Realizimi i “Udhërrëfyesit të Studentit”.....	6
2.4. Botimi i Revistave Shkencore dhe Revistës së Studentit	7
3. Ndërtimi i një sistemi elektronik të komunikimit të brendshëm.....	8
3.1. Përdorimi i domain unifikues unitir.edu.al	8
3.2. Vendosja e sistemit e-Student.....	8
4. Krijimi i një rrjeti të gjërë efektiv të kontakteve.....	9
4.1. Zgjerimi i bashkëpunimit të FGJH me institucione dhe biznese.....	9
4.2. Fokusi ndaj Projekteve të EU dhe Partnerëve të huaj.....	9
4.3. Krijimi i rrjetit Alumni FGJH.....	10
5. Promovimi i jetës studentore	10
5.1. Krijimi i Klubeve Studentore.....	11
5.2. Shkollat verore/dimërore	12
6. Marrëdhënie të ngushta dhe efektive me shkollat e mesme	14
6.1. Trajnimet të vazhduara me mësuesit e shkollave të mesme.....	14
6.2. Projekte të përbashkëta me shkollat e mesme.....	15
7. Pjesëmarrja në panaire dhe evenete promovuese.....	16
7.1. Pjesëmarrje në panairin “Work & Study”	16
7.2. Pjesëmarrje në panairin “Ditët e Informimit të Maturantëve”	16
7.3. FGJH “Open day”	16



Hyrje

Strategjia dhe Politikat e Marketingut të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja mbështetet në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, në strategjinë kombëtare të arsimit 2021-2026.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në misionin e tij ka fuqizimin e pozicionit të tij, si institucioni kryesor me kontributin më të madh në vend në mësimin e gjuhëve të huaja, duke prodhuar specialistë dhe profesionistë të gjuhëve të huaja, që jepin ndihmesë në zhvillimin e vendit dhe intergimin evropian. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja po luan një rol të rëndësishëm në realizimin e strategjisë së zhvillimit institucional të Universitetit të Tiranës, si pjesë përbërëse e tij duke bashkëvepruar me strukturat dhe fakultetet e tjera të tij.

Një prej politikave përfundimtare e mëtejshme të njësive bazështë edhe Strategjia e Marketingut të FGJH-së. Zhvillimi i njësive bazë do të fokusohet veçanërisht në politikat e komunikimit në kontekstin e zhvillimit të sotëm të informacionit.

Pikat ku do të mbështetet Strategjia e Marketingut janë përcaktuar si më poshtë:

1. Ngritja e Zyrës së Këshillimit të Karrierës së Studentëve.
2. Projekzioni i Imazhit të Institucionit.
3. Ndërtimi i një sistemi elektronik të komunikimit të brendshëm.
4. Krijimi i një rrjeti të gjërë efektiv të kontakteve.
5. Promovimi i jetës studentore.
6. Marrëdhënie të ngushta dhe efektive me shkollat e mesme.
7. Pjesëmarrja në panaire dhe evenete promovuese.



1. Ngritja e Zyrës së Këshillimit të Karrierës së Studentëve

Ngritja e Zyrës së Këshillimit të Karrierës së Studentëve në FGJH po luan një rol kyç në informimin, komunikimin, marketingun dhe promovim e programeve të studimit dhe shërbimeve që ofrohen nga Fakulteti ndaj studentëve të tij, për nxënësit e shkollave të mesme, institucionet, ndërmarrjet, si edhe aktorë të huaj në rajon dhe më gjërë.

Zyra e Këshillimit të Karrierës në FGJH ka përfaqësuesin e saj me kohë të plotë dhe gjithashtu ka të angazhuar në përbërjen e saj disa pedagogë të fakultetit, ku në qendër të punës së tyre kanë studentët. Ata orientojnë dhe ndihmojnë studentët të jenë të suksesshëm në ngritjen e karrierës së tyre profesionale:

- duke lidhur interesat, aftësitë, vlerat dhe personalitetin e tyre me botën e punës;
- duke inkurajuar studentët të testojnë idetë e tyre nëpërmjet internshipeve, intervistave informative, vullnetarizmit dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare të organzuara në FGJH;
- duke u kushtuar vëmendje të veçantë përgatitjes së prezantimit të tyre, CV-ve, letrave të shprehjes së interesit për punë, si edhe përgatitjes së tyre për t'u intervistuar.

2. Projekioni i Imazhit të Institucionit

Ndërtimi i markës dhe identitetit në promovimin e imazhit të fakultetit shërben për të identifikuar thelbin e institucionit tonë dhe për të kuptuar përbërjen e tij: çfarë përcakton fymën dhe përvojën e FGJH, si mund ta dallojmë ate nga konkurrentët?

Projekioni i imazhit të institucionit shërben të njohim audiencën ekzistuese dhe potenciale të synuar, për të kuptuar demografinë, për të identifikuar se çka motivon procesin e vendimarrjes dhe për të arritur të prekim mendjet dhe zemrat e tyre.


Projektimi i materialeve të publicitetit dhe marketingut, që promovojnë një profil dhe një vlerë të dallueshme dhe të shquar të markës e imazhit të duhur brenda dhe jashtë institucionit, do të bëhet nëpërmjet metodave bashkëkohore e në planet e veprimit si më poshtë.



2.1. Modeli i ri i website zyrtar të FGJH-së


Rindërtimi i faqes zyrtare web të FGJH-së me fokus aksesin e thjeshtë në përcjelljen e informacionit tek sa më shumë palë të interesuara, studentë, nxënës të shkollave të mesme e prindërit e tyre, institucionet vendase, si edhe homologët e huaj, duke e ndërtuar web në të gjitha gjuhët e programeve që ofrohen nga çdo departament: shqip, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht, greqisht, rusisht, turqisht.

Paraqitura e web-it në disa gjuhëtë huaja, jo vetëm që rrit imazhin e fakultetit si një institucion ndërkombëtar, por gjithashtu bën të mundur aksesimin ngakopmani dhe institucionet të vendeve të ndryshme, të interesuar për bashkëpunim.



2.2.Përditësimi i faqes Facebook zyrtar të FGJH-së

Përditësimi i faqes zyrtare të FGJH-së në Facebook bëhet në mënyrë ditore me gjithë aktivitetet e njoftimet e çdo eventi që zhvillohet në fakultet, për të rritur e ngjallur interesin dhe pjesëmarrjen e studentëve në jetën akademike e shkencore të fakultetit.





Facebook FGJH është tashmë një dritare bashkëkohore në përcimin e informacionit, veçanërisht tek brezi i ri, i cili është ndjekësi kryesor (por jo vetëm) i këtij aplikacioni. Facebook FGJH i bën studentët me dije në kohë reale për aktivitetet që zhvillohen në fakultet dhe për gjithë informacionet e rëndësishme në shërbim të procesit akademik, si njoftime mbi trajnime, aktivitete kulturore, çeljen e programeve mësimore dhe oraret përkatëse, thirrje për projekte, etj.



2.3. Realizimi i “Udhërrëfyesit të Studentit”

Në fillim të vitit akademik 2021-2022 u realizua “Udhërrëfyesit të Studentit” si një guidë me informacione të dedikuara për studentët e FGJH, në të cilën gjenden shumë informacione që lehtësojnë përshtatjen e studentëve të rinj me jetën akademike. Guida është ndërtuar edhe në gjuhën angleze me qëllim shpërndarjen e saj tek bashkëpunëtorët e huaj. Gjithashtu pjesë e imazhit janërealizimi i materialeve promocionale të loguara si çanta, stilolapsa, blloqe/agjenda, të cilat u janë shpërndarë studentëve të rinj, bashkëpunëtorëve dhe të ftuarve të ndryshëm pranë FGJH-së.



2.4. Botimi i Revistave Shkencore dhe Revistës së Studentit

Botimi i Revistave Shkencore të FGJH është një mundësi e paraqitjes së potencialit kërkimor shkencor të profesoratit të FGJH. Këto revista periodike kanë në përbajte kërkime shkencore, informacione të ndryshme në fushat e didaktikës, përkthimit, sintaksës etj. Ato paraqesin kontributet autorësh si në gjuhësi, përkthim, letërsi, komunikim, kulturë, qytetërim etj.

Deri më tani janë botuar tre revista shkencore me përbajtje të rëndësishme të bashkëpunëtorëve, shqiptar apo të huaj dhe gjen në faqet e tyre përbajtje të rëndësishme të bashkëbisedimit të hapur shkencor, të arritjeve dhe pikave të referimit për të çuar më tej punën dhe kërkimin serioz në dobi të pasurimit dhe përforcimit të rezultateve shkencore. Fusha e kontributeve do të jetë gjithmonë e më e gjerënë botimin e revistave shkencore.



Strategjia e zhvillimit të Fakultetit ka në qendër të saj studentin, ndaj edhe si pjesë e strategjisë marketing është botimi i Revistës së Studentit, e cila ka në thelb promovimin e aktivitetit shkencor të studenteve të fakultetit, me shkrime mbi hulumtime të ndryshme dhe kërkime shkencore. Botimi i kësaj reviste vjen si një nismë e drejtuar nga Klubi i Përgatitjes së Revistës Studentore, me në krye studentë dhe pedagogë që ndihmojnë e orientojnë studentët për realizimin cilësor të materialeve. Botimi i Revistës së Studentit fillimisht do të jetë online dhe do të shfaqet në një rubrikë të dedikur në web zyrtar të FGJH, si edhe Facebook.



3. Ndërtimi i një sistemi elektronik të komunikimit të brendshëm

Ndërtimi i një sistemi të fuqishëm dhe efikas të komunikimit të brendshëm në nivelin teknik të kompjuterizimit dhe krijimi i sistemit të intranetit, do te ndihmoje ne standartizimin e komunikimit te brendshem dhe mbajtjen e nje linje komunikimi efikase.

3.1. Përdorimi i domain unifikues unitir.edu.al

Si një hap i parë është standartuar komunikimi i brendshëm midis personelit akademik, administrativ dhe studentëve, nëpërmjet përdorimit të adresës email zyrtar në domain: *unitir.edu.al*. Kjo mënyrë ka lehtësuar gjetjen e kontakteve për të gjithë palët dhe ka bërë të mundur formalizimin e komunikimit dhe përcjelljen në kohë më të shpejtë të informacionit.

3.2. Vendosja e sistemit e-Student

Ka nisur punë projekti i përbashkët i Universitetit të Tiranës më të gjithë fakultetet në përbërjen e tij, për vendosjen e sistemit elektronik e-Student të menaxhimit të informacionit. FGJH si një promotor i këtij procesi, tashmë është në fazë të avancuar për implementimin e sistemit elektronik brenda vitit akademik 2021-2022. Ky sistem do të lehtesojë mirëmbajtjen e të dhënavë të sekretarisë mësimore, të pedagogëve dhe do të standartizojë informacionin ndaj studentëve, duke ruajtur parimet e konfidencialitetit dhe të ruajtjes së informacionit. Gjithashtu sistemi elektronik do të lehtesojë në raportimin periodik ndaj MAS apo autoritetve brenda fakultetit.



4. Krijimi i një rrjeti të gjerë efektiv të kontakteve

Krijimi i një rrjeti të gjerë efektiv të kontakteve mbështetjes së ndërsjellë dhe njohjes me njësi të tjera të huaja mbi baza të bashkëpunimit, projekteve të përbashkëta, programeve të shkëmbimit të studentëve dhe bashkëpunimeve të tjera.

4.1. Zgjerimi i bashkëpunimit të FGJH me institucione dhe biznese

Në realizimin e kësaj pike, po ndërtohet një database për marrëveshjet e nënshkruara midis FGJH dhe institucioneve e kompanive të ndryshme brenda vendit, me qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë dhe ofrimin e mundësive të shumta për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve tanë.

Gjithashtu çdo vit do të zhvillohet forumi i bizneseve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për të orientuar më mirë studentet në tregun e punës dhe për të njohur aftësitë profesionale që kërkon sot tregu i punës. Kjo do të sjell përmirësimin e kurrikulave dhe që programet e studimit të përshtaten më mirë me tregun e punës.

Zhvillimi i marrëdhënieve të reja kërkimore me bizneset dhe institucionet e tjera akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, kërkon bashkimin e energjive të brendshme të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve të fakultetit në bashkëpunim me Rektoratin e UT, Fakultetet dhe strukturat e tjera të UT, si edhe mbështetjen e partnerëve të shumtë kombëtarë e ndërkombëtarë të sferës universitare, të shoqërisë civile, të komunitetit dhe të biznesit.

4.2. Fokusi ndaj Projekteve të EU dhe Partnerëve të huaj

U ngrit dhe forcua Zyra e Projekteve, si njësi e dedikuar brenda fakultetit, për ofrimin e mundësive të bashkëpunimit dhe partneritetit në projekte kombëtare e ndërkombëtare, të cilat



rrisin nivelin profesional të personelit tonë dhe ofrojnë oportunitete në zhvillimin me tej të kërkimit shkencor brenda fakultetit.

Mbështetja financiare për kërkimin shkencor kërkon diversifikim të burimeve financiare të fakultetit duke mos u mbështetur vetëm në burimet e brendshme. Inkurajimi për aplikime në projekte ndërkombëtarë që kanë në qënder kërkimin dhe financohen nga BE apo fondacione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimi i ngushtë me sektorin privat duke e orientuar kërkimin shkencor nga tregu, janë disa nga instrumentat që do të përdoren për të rritur bashkëpunimin me partnerët e huaj.

4.3. Krijimi i rrjetit Alumni FGJH

Krijimi i rrjetit Alumni FGJH, ose ndryshe krijimi i rrjetit të ambasadorëve të markës, i jep një dimension të ri zërit të FGJH në rrjetin e personaliteteve të afirmuara sot në vend dhe jashtë. Ata kanë ofruar mundësitë të jenë pjesë e veprimitarive të ndryshme, si leksione të hapura, webinare, konferanca, trajnime, promovime të bizneseve apo sipërmarrjeve të tyre, si edhe do t'u japid mundësi studentëve që të njihen me praktikat e punës, të lidhin kontakte të rëndësishme me biznese, institucione dhe organizata, të cilat do t'iua mundësojnë kryerjen e stazhit, praktikës profesionale apo edhe punësim në të ardhmen.

Ne do të identifikojmë, hartojmë dhe ndjekim të diplomuarit tanë në mënyrë efikase dhe do të sigurohem që partneritetet tona me ta synojnë të përputhin interesat e tyre me prioritetet tona. Krijimi i një forumi të përhershëm me punëdhënësit dhe krijimi i bazës së të dhënavë për të diplomuarit, do të krijojë një terren të sigurtë për mbështetjen e studentëve të rinj.

5. Promovimi i jetës studentore

Promovimi i jetës studentore brenda FGJH-së nëpërmjet aktivitetave kulturore, sportive, artistike, sociale dhe vullnetarizmit me anë të Klubeve Studentore, si dhe krijimi i një qendre për



aktivitete jashtëkurrikulare, që do të nxisë studentët të shpenzojne kohë më shumë pranë kampusit studentor dhe të gjejnë mbështetje brenda FGJH-së për orientime lidhur me zhvillimin e tyre në karrierë dhe aftësive të punësimi, në një mënyrë që është e arritshme për të gjithë studentët, gjatë gjithë kohës së tyre të studimit tek ne.

Mirëqenia e studentëve gjatë jetës studentore dhe impakti pozitiv që ata marrin gjatë kohës së studimeve në FGJH, përcillet pozitivisht në progresion rritës tek familjarët, miqtë e moshatarët e tyre, duke shpërndarë më shpejt zërin e FGJH-së për studentët e ardhshëm.

5.1. Krijimi i Klubeve Studentore

Klubet Studentore ndihmojnë në lidhjen e studentëve me një rrjet të gjerë njerëzish dhe profesionistësh, e për më tepër me shumë mundësi, i vënë në kontakt edhe me punëdhënësin e tyre të ardhshëm.

Praktika po na tregon, se njoftimi i studentëve për krijimin e klubeve studentore ka dhënë rezultat dhe menjëherë jane krijuar 10 klube me përbajtje artistike, sportive, vullnetare e inovatore te cilat janë:

- ✓ Klubi i Ambientalistëve
- ✓ Klubi i Teatrit
- ✓ Klubi Letrar
- ✓ Klubi Sportiv
- ✓ Klubi i Debatit
- ✓ Klubi i ICT
- ✓ Klubi i Muzikës
- ✓ Klubi i Përgatitjes së Revistës Studentore
- ✓ Klubi i Vullnetarizmit
- ✓ Klubi i Artit



FGJH u jep studentëve mbështetje të plotë dhe nxitje, që të përfshihen plotësisht në jetën universitare përmes klubeve studentore dhe ngjarjeve akademike e sociale. Numri i pjesëmarrësve është rritur në secilin klub. Studentët të organizuar midis tyre, aplikuan në thirrjet për projekte brenda FGJH, ku dolën 3 projekte fituese nga klubet studentore.

5.2. Shkollat verore/dimërore

Shkollat verore dhe dimërore janë një mënyrë e promovimit të aktiviteteve akademike brenda FGJH-së. Nëpërmjet këtyre programeve synohet t'u mësohet studentëve të nivelit bachelor, master, si edhe studentëve të tjere të interesuar përvetesimin e gjuhës së huaj në nivelet A1, B1.

Në të njëjtën kohë studentët pjesëmarrës në këto shkolla, përmes leksioneve dhe referateve që mbahen nga profesorë dhe studiues të universiteteve nga vendet e huaja të origjinës, i pajisin me njohuri shtesë mbi marrëdhëniet historike, gjuhësore, letrare, trashëgiminë kulturore të vendit të origjinës etj.

Në kuadër të këtyre shkollave verore janë kryer disa të tillë si më poshtë:

- Programi veror për nivelet fillestare HSK1 dhe HSK2 për mësimin e gjuhes kineze nepërmjet platformës ZOOM.
- Shkolla verore e Osmanishtes, organizuar për të katërtin vit rradhazi nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, Dega e Gjuhës Turke, në bashkëpunim me Universitetin Aydin të Stambollit, Universitetin Bartin të Turqisë, Departamenti i Dialekteve Turke me të cilin Universiteti i Tiranës ka marrëveshje Erasmus+.
- Shkolla verore e Bullgarishtes e organizuar nga Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Ballkanike dhe Qëndra e Gjuhëve të huaja në kuadër të programit Erasmus+ që



Universiteti i Tiranës ka me Universitetin Veliko Tărnovo "St. Shën Kirili dhe Metodi" të Bullgarisë.

- Shkolla dimërore e gjuhës kineze, e cila pritet të fillojë nga data 11.02.2022 dhe që do të jetë një kurs 20 ditor me nga 2 orë në ditë mësim. Qëllimi i kësaj shkolle dimërore eshtë hapja e një dritare të vogël të gjuhës kineze, historisë dhe literaturës; për të ngjallur interesin e studentëve në gjuhën dhe kulturën kineze. Ky kurs do të përmbajë literaturë, praktikimin e gjuhës kineze si dhe udhëtime në terren.



Regjistrimi në kursin e gjuhës dhe
kulturës Kineze pranë Institutit Konfuci-
UT - Semestri i parë 2021-2022 (Në
auditor ose online, në varësi të
udhëzimeve në vijim nga UT dhe MASR)



6. Marrëdhënie të ngushta dhe efektive me shkollat e mesme

Mbajtja e marrëdhënieve me stafin pedagogjik dhe nxënësit e shkollave të mesme, mban të zgjuar interesin për të njohur FGJH nga afër, si në vijimin e studimeve, ashtu edhe në marrjen pjesë në aktivitete didaktike, informuese apo kulturore.

6.1. Trajnime të vazhduara me mësuesit e shkollave të mesme

Zhvillimi profesional nëpërmjet moduleve të trajnimit do t'i ndihmojë mësuesit në përditësimin e aftësive të tyre dhe në përfstimin e aftësive të reja, duke i inkurajuar ata që vazhdimisht të vijnë me mënyra të reja të trajtimit të nxënësve.

Trajnimi i mësuesve do të mundësojë përgatitjen e nxënësve sa më të suksesshëm në një botë çdo ditë në zhvillim. Nxënësit do të jenë të aftë në përdorimin e teknologjive e reja, do të mund të marrin arsimimin e duhur me qëllim përbushjen e kërkesave të tregut, do të arrijnë të komunikojnë në mënyrë efikase dhe të mendojnë në mënyrë kritike për zgjidhjen e problematikave që do të hasin dhe vizionin e tyre për të ardhmen.

Modulet tona synojnë që të zhvillojnëaftësi kyç për një nxenie me jetëgjatësi si: a) aftësiapër të komunikuar dhe për t'u shprehur; b) aftësiapër të menduar; c) aftësia për të nxënë; ç) aftësi personale; dh) aftësi qytetare; e) aftësi digitale.

- Modulet e përzgjedhura në fushën e Kurrikulës i vinë në ndihmë mësuesëveqë të kenë një qasje ndryshe ndaj orës mesimore, duke vendosur në qendër nxënësin dhe nevojat e tij, si ato fizike edhe ato gjuhësore.
- Modulet që do të ofrohen për Mësimdhënen - Të nxënët - Vlerësimi i nxënësit synojnë të motivojnë mësuesit dhe në të njejtën kohë t'i aftësojnë ata në vlerësimin e aftësive ligjërimore.



- Modulet që do të ofrohen në fushën e Etikës, Komunikimit dhe Pedagogjisë do t'i përditësojnë mësuesit me aftësitë kros (soft skills) në mënyrë që ata të përgatisin qytetarë të denjë për shekullin e 21-të, të cilët janë të aftë të lidhin teorinë më praktikën; do t'i pajisin mësuesit me ide të reja, metoda dhe aktivitete që do t'i ndihmojnë si të integrojnë këto aftësi në përditshmérinë e tyre në shkollë dhe jo vetëm.
- “Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen - Profili i mësuesit gjithëpërfshirës” ka për qëllim nxjerrjen në pah të aftësive thelbësore, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithsecili mësues, si ai që përgatitet t'i bashkohet rradhëve të profesionit të mësuesisë ashtu dhe ai që është në stazh, pavarësisht nga lënda që jep, specializimi apo grupmosha ku jep mësim.

6.2. Projekte të përbashkëta me shkollat e mesme

Në fokus të strategjisë marketing janë maturantet, si grupei i parë i synuar, me qëllim rritjen konstante dhe stabël të numrit të studentëve të interesuar për të zgjedhur programet e FGJH. Një mënyrë për të përcuar fjalën në shkollat e mesme, do të jetë bashkëpunimi me projekte, të cilat angazhojnë nxënësit e shkollave të mesme.

Projekte të ndryshme të cilat përfshijnë shkollat e mesme me aktivitete të përbashkëta, si p.sh. projekti fitues “Zëri i tokës na therret” i cili është një projekt i studentëve të FGJH në Klubin e Ambjentalistëve. Objektivi kryesor i këtij projekti është mbrojtja e ambientit dhe si qëllim final ka sensibilizimin dhe edukimin e nxënësve të shkollave të mesme. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të këtij projekti lidhet me vizita të shumta, që do të zhvillohen në shkollat e mesme, si edhe do të organizohen olimpiada përfshirjen aktive të nxënësve. Kjo ndihmon në familjarizimin dhe njohjen nga afër të potencialit akademik të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.



7. Pjesëmarrja në panaire dhe evenete promovuese

7.1. Pjesëmarrje në panairin “Work & Study”

Pjesë e strategjisë së marketingut të FGJH-se është edhe pjesëmarrja në Panairin “Work & Study”, i cili organizohet nga Bashkia e Tiranës, Dhomë e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë si dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në këtë panair marrin pjesë universitete publike e private, kompani dhe institucione të ndryshme. Ky është një event i rëndësishëm ku Univeristetet u japin maturantëve informacion të detajuar mbi programet e studimit që ofrojnë, ku veçanërisht FGJH orienton maturantët/studentët potencialë mbi oportunitetet që ofron zgjedhja e studimeve pranë fakultetit tonë. Kompanitë e rekrutimit dhe institucione të tjera japin informacion mbi aktivitetin dhe shërbimet që ofrojnë dhe njëkohësisht njoftojnë mbi vende të lira pune.

7.2. Pjesëmarrje në panairin “Ditët e Informimit të Maturantëve”

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Drejtore të Arsimore Vendore dhe institucionet e arsimit të lartë, në kuadër të planifikimit të karrierës organizojnë: “Ditët e Informimit të Maturantëve”. Përgjatë muajit Mars maturantët kanë mundësinë të takohen dhe informohen drejtpërdrejtë nga përfaqësuesit e universiteteve ku shpalosin programet dhe mundësitë që ofrojnë për të rinjtë, të cilët do të nisin rrugëtimin akademik.

7.3. FGJH “Open day”

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja do të hapë dyert e tij në një “Open day” për të gjithë maturantët të cilët duan të vizitojnë ambientet e FGJH-së, si edhe të marrin sa më shumë informacion mbi programet që ofrohen në çdo degë e cikël, për disiplinat e ndryshme që ofrojmë, si dhe përgjigjet pse ata duhet të zgjedhin këtë fakultet. Ata do të kenë një panoramë të qartë të fakultetit tonë, do



të marrin këshilla dhe njohuri nga studentët tanë aktualë, të cilët do i informojnë mbi jetën e pasur studentore, me aktivitete dhe klube artistike e sportive, veprimitari kulturore, konkurse, ekskursione, projekte, seminare, konferanca kombëtare e ndërkombëtare, si edhe do t'u vijnë në ndihmë maturantëve të bëjnë zgjedhjen e duhur, për të vijuar me një karierë të mëtejshme më të sigurtë me mundësi pa fund punësimi, brenda dhe jashtë vendit.

Fuqizimi i aktivitetit “Dyer të hapura” për maturantët, i njeh ata me mjediset e përshtatshme, moderne e të pajisura me teknologji inovative, laboratorët informatike të përkthimit, që ju vijnë në ndihmë gjatë procesit të mësimdhënies e të mësim-nxënies. Maturantët kanë mundësi të prekin nga afër bibliotekën fizike të pasur dhe të përditësuar me tituj bashkëkohorë të autorëve më në zë, si edhe bibliotekën digitale e të marrin njohuri se si funksionin ajo. Ata kanë mundësi të bisedojnë me pedagogët tanë me përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe të pakursyer në çdo kohë, për t’iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të studentëve.

Miratoi

Dekani

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

